



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E MBROJTJES

**SEKRETARI I PËRGJITHËMDREJTORIA E PËRGJITHSHME E  
EMERGJENCAVE CIVILE**

Nr. \_\_\_\_\_ prot.  
16 . 1 . 2019

Tiranë, më

Lënda: Kërkesë.

**KRYETARIT TË BASHKISË**

Siç jeni në dijeni, situatat e kohëve të fundit të krijuara nga reshjet e borës dhe të shiut, në një pjesë të madhe të territorit të vendit, krijuan problematika të shumta, të tilla si, bllokimin e disa segmenteve të akseve rrugore kombëtare, bllokimin e shumë segmenteve të rrugëve rurale, ndërprerjen e komunikimit dhe të veprimtarisë njerëzore, si dhe ndërprerjen e procesit mësimor dhe të furnizimit me energji elektrike.

~~Kjo situatë sjell edhe njëherë në vëmendjen e të gjithëve faktin e njohur, se Shqipëria është një vend shumë i prekshëm nga fatkeqësitë natyrore, ku pothuajse çdo vit vendi ynë ka rritje të cenueshmërisë ndaj këtyre fatkeqësive, rritje të ndjeshmërisë së tyre, si dhe të pamjaftueshmërisë së kapaciteteve përballuese dhe atyre përshtatës.~~

Për shkak se problemikat kryesore të shkaktuara nga reshjet e borës dhe të shiut lidhen me veprimtarinë e bashkisë, ku mund të veçonim, parashikimin e fondeve për masat mbrojtëse, parandaluese, ndërhyrëse dhe rehabilituese për emergjencat civile; evidentimin e burimeve materiale dhe financiare shtetërore dhe joshtetërore, si dhe të përcaktimit për mënyrën e përdorimit të tyre në situata emergjente; përditësimin e të gjitha burimeve dhe kapaciteteve njerëzore materiale e teknike në nivel bashkie dhe përditësimin e planeve për angazhimin e tyre në kohë reale në rast të një situatë emergjente që mund të krijohet, për të shmangur në maksimum dëmet dhe humbjet që mund të shkaktohen; si dhe në zbatim të Ligjit nr. 8756, datë 26.03.2001, “Për emergjencat civile”, i ndryshuar, të Ligjit Nr. 139, datë 17.12.2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, kërkojmë nga ana juaj:

- Dërgimin në Drejtorinë e Përgjithshme të Emergjencave Civile, Ministria e Mbrojtjes, të listës së plotë të kompanive të kontraktuara nga ana e institucionit tuaj për mirëmbajtjen e akseve rrugore, si edhe të kapaciteteve njerëzore dhe teknike të tyre, të parashikuara në kontratë për mirëmbajtjen e secilit prej segmenteve rrugore në territorin e bashkisë suaj;
- Listën e ~~plotëdetajuar~~, të kapaciteteve faktike njerëzore dhe teknike, ~~1~~ (llojin e automjeteve, targa të secilit automjet) të përdorur në ditët e reshjeve të borës dhe të shiut të fillimit të janarit 2019, nga firmat kontraktore për mirëmbajtjen e secilit nga segmentet rrugore dhe performancën e treguar nga secili prej tyre.

~~—Listën e detajuar, të kapaciteve faktike njerëzore dhe teknike të përdorur nga vetë bashkia për mirëmbajtjen e secilit nga segmentet rrugore dhe gjendja e kalueshmërisë së tyre gjatë ditëve të reshjeve të borës.~~

**Formatted:** Don't add space between paragraphs of the same style

**Formatted:** Font:

- ~~—~~
- ~~- Informacionin e plotë mbi gjendjen problematikat aktuale të akseve rrugore, të problematikave që janë vërejtur në secilin prej akseve rrugore problematike, si dhe në territorin e bashkisë suaj dhe masat që do të merren nga ana juaj për përballimin e këtyre situatave në të ardhmen. Informimin periodik në vazhdim për Ministrinë e Mbrojtjes, deri në eliminimin e problematikave të krijuara nga kjo situatë.~~

Duke ju falënderuar ~~për mirëkuptimin paraprakisht, mbetemi në pritje të një përgjigje të shpejtë.~~

**SEKRETARI PËRGJITHSHËM**

**NË MUNGESË**

**DREJTORI PËRGJITHSHËM I POLITIKAVE TË MBROJTJES**

**Florian Kali**

**DREJTORI PËRGJITHSHËM**

**HAKI ÇAKO**